



**UDHËZIM**

Nr. 02 Datë 30.12.2024

**“ PËR SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.8, DATË 01.09.2021 “MBI  
HARTIMIN E PLANIT TË ZBATIMIT TË KONTRATËS”**

Agjencia e Prokurimit Publik në mbështetje të gërmës “b” të nenit 23, nenit 124 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, pikës 4, 8, të nenit 107 dhe nenit 115 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar,

**UDHËZON:**

1. Paragrafi i parë i pikës 1 riformulohet me këtë përmbajtje:

”Autoritetet/entet kontraktore pas nënshkrimit të kontratave të lidhura në përfundim të procedurave me vlerë mbi kufirin monetar të prokurimeve me vlerë të vogël, të cilat kanë kohëzgjatje jo më pak se 6 muaj, nisur nga natyra e objektit të kontratës dhe kohëzgjatja e zbatimit të saj, hartojnë planin e zbatimit të kontratës, në përputhje me parashikimet ligjore të prokurimit publik dhe me legjislacionin e fushës në fuqi”.

2. Në pikën 2, pas fjalisë së parë shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

”Plani i zbatimit të kontratës, duhet të nënshkruhet nga autoriteti ose enti kontraktor dhe operatori ekonomik brenda 10 ditëve nga nënshkrimi i kontratës dhe do të bëhet pjesë e dosjes së zbatimit të kontratës që administrohet pranë autoritetit/entit kontraktor”.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**Reida Kashta**